



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**A.nr. 505/2025**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Yeniliçki Turk Halk Partisi (YTHP), me seli në Prizren, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtura më datë 09.shkurt.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.02.2025, merr këtë,

## V E N D I M

**HEDHEN** të palejuara ankesat A.nr.505/2025, A.nr.522, A.nr.523, A.nr.524, A.nr.525/2025, të datës 10.02.2025, si dhe ankesa A.nr.576/2025 të datës 11.02.2025 të parashtruara nga subjekti politik Yeniliçki Turk Halk Partisi (YTHP), me seli në Prizren, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtura më datë 09.02.2025.

## A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar ankesat: Anr.505/2025, Anr.522/2025, Anr.523/2025, Anr.524/2025, Anr.525/2025 dhe A.nr 576/2025 nga subjekti politik Yeniliçki Turk Halk Partisi (YTHP), me seli në Prizren më datë 10.02.2025 dhe 11.02.2025 për shkak parregullsive gjatë numërimit në Qendrat e Votimit, 1801, 1902, 1914 dhe 1923, 3201/05, 3201/03, 3201/04,

Në ankesën A.nr 505/2025 subjekti politik Yeniliçki Turk Halk Partisi (YTHP), theksojnë se sipas informatave nga votuesit në Qendrat e Votimit poshtë shënuar si Parti YTHP-së kërkojnë edhe njëherë rivotimin e vendvotimeve të poshtë shënuar. Për shkak të numrit të jo të mjaftueshëm së anëtarëve nëpër QV dyshojnë për votat të shpallura në web faqen e KQZ-së. Kërkojnë që të rishqyrtohet kërkesa tyre për QV: Qendrën e Votimit: 1901 në Sh.F.M.U “ Naim, Frashëri” R.r Adrian Krasniqi në VV 4,6,7,9, Qendrën e Votimit: 1902 në Sh.F.M.U “ Sami Frashëriu” R.r Ibrahim Lutfiu në VV 2,3,4,6, Qendrën e Votimit: 1914 në Sh.F.M.U “ Elena Gjika ” R.r Emin Duraku në VV 2,3,4,, Qendrën e Votimit: 1923 në Sh.F.M.U “ Meto Bajraktari” R.r Josip Rela” në VV 2,3,4,7.

Në ankesën A.nr 523/2025 subjekti politik Yeniliçki Turk Halk Partisi (YTHP), pretendon se pas publikimit të rezultateve të datës më 10 shkurt 2025 në KQZ në Komunën e Mamushës, Qendrën e Votimit, në VV numër 3201/05, ka dyshime se është bërë keqpërdorimi i procesit zgjedhor bazuar në rrjetin e dyshimtë të numrit të votuesve duke krahasuar viteve të kaluara dhe shihet haptazi se ka një rritje të dyshimtë të votave për KDTP në këtë VV. Në vazhdim të ankesës theksojnë se nga informatat e vëzhguesve mungojnë 3 nënshkrime në Librin e Votuesve. Po ashtu edhe në VV numër 3201/03, 3201/02, 3201/4 e pretenduar në Ankesën Anr.522/2025, Anr.524/2025 , Anr.525/2025, ka rritje të dyshimtë të votave për KDTP në këtë vendvotim. Kërkojnë nga PZAP që të merren masa që të bëhet kontrollimi i nënshkrimeve, fletëvotimeve dhe anulimin e votave në VV 3201/5, rinumërimin e votave në VV 3201/03, 3201/02, 3201/4 në Komunën e Mamushës.

Në ankesën A.nr 576/2025 subjekti politik Yeniliçki Turk Halk Partisi (YTHP), pretendon se se sipas rezultateve preliminare të shpallura nga KQZ-ja në mëngjes të datës 10.02.2025, subjekti tyre kishte 212 vota në Komunën e Lipjanit, ndërsa pas pasdite pas përditësimit janë hequr 169 vota dhe numri i votave për partinë në Lipjan u reduktua në 43. Sipas pretendimeve në ankesë ky fakt është i dyshimtë nga drejtuesit e partisë dhe për këtë arsye kërkojnë që të rinumërohen të gjitha votat e partisë së tyre në Lipjan.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 11.02.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) theksohet se KQZ, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj jep sqarimet/ përgjigjet si më poshtë: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), bazuar në Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës neni 102 paragrafi 5 ka bërë përmbledhjen e rezultateve preliminare (paraprake) të vendvotimeve dhe i bën publike përmes platformës elektronike me datën 10.02.2025. Më tutje theksojnë se rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të ndryshohen, korrektohen dhe plotësohen, nga Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) dhe Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), e cila mundëson në evitimin e çdo gabimi teknik pas publikimit të rezultateve përfundimtare të këtyre zgjedhjeve nga KQZ-ja. Në vazhdim të përgjigjet theksojnë se dispozitat ligjore në Ligji nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/ L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, gjegjësisht neni 119 i LZP-së, nuk parashihet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohen rezultatet preliminare të kësaj natyre të KQZ-së, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së, të cilat mund të ankimohen në PZAP. Sipas përgjigjes nga KQZ, pretendimet e palës ankuese nuk kanë asnjë bazë ligjore dhe nuk janë të mbështetura nga ndonjë provë e qartë dhe bindëse, dhe sipas dispozitave ligjore të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 119 paragrafi 3 kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) që pretendimet e palës ankuese t'i hedhë si të palejuara.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të

Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: A.nr.505/2025, A.nr.522/2025 A.nr.523/2025, A.nr.524, A.nr.525 të datës 10.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.505/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga i njëjti subjekt politik për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesat janë të palejuara**

Paneli vlerëson se pretendimi i palëve ankuese edhe pse i referohen parregullsive në ditën e votimit, për shkak se përmes këtyre ankesave atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimeshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet E Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar


Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Nenit 13.3 të Rregullores Nr.01 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, ne të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim.”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesave të palejueshme nuk e prejudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 13.3 Rregullores Nr.01 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**A nr. 505/2025 më datën 12.02.2025**

**Kryesues i Panelit**  
**Ramush Bardiqi**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.